



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
KOMISIONI PËR ÇËSHTJET LIGJORE, ADMINISTRATËN PUBLIKE DHE TË
DREJTAT E NJERIUT

Tiranë, më 03.06.2019

RAPORT

PËR

**“PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT
TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË
SË MBRETËRISË SË ARABISË SAUDITE, PËR SHËRBIMET
AJRORE”**

Hyrje

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e datës 03.06.2019, mori në shqyrtim projektligjin “Për Ratifikimin e Marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë së Arabisë Saudite, për Shërbimet Ajrore”. Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut caktoi relator për shqyrtimin e këtij projektligji deputeten Aurora Mara.

Në mbledhjet e Komisionit për të mbrojtur projektligjin dhe për të dhënë shpjegime për pyetjet e anëtarëve të Komisionit ishin të pranishëm edhe përfaqësues të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

I. BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës, sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

Ratifikimi i kësaj marrëveshje bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kreu II “Marrëveshjet Ndërkombëtare”, neni 121 i saj.

II. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT DHE PËRMBAJTJA E TIJ

Qëllimi i projektligjit është ratifikimi i marrëveshjes për shërbimet ajrore, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, dhe qeverisë së Mbretërisë së Arabisë Saudite për

të krijuar hapësira dhe mundësi më të mira për shtetasit e të dyja palëve për transport udhëtarësh, mallrash dhe dërgesash postare.

Si shtet palë në Konventën mbi Aviacionin Civil Ndërkombëtar, Republika e Shqipërisë mbart detyrimin që rrjedh nga kjo konventë për koordinimin e veprimtarisë në fushën e aviacionit civil dhe bashkëpunimin në fushën e transportit ajror, mbështetur në parimin e komunikimit ndërmjet vendeve.

Ratifikimi i kësaj marrëveshjeje synon krijimin e kushteve lehtësuese, nëpërmjet të cilave do të bëhet e mundur lëvizja pa pengesa për shtetasit e të dy vendeve, si dhe do të rritet bashkëpunimi ndërmjet palëve.

Marrëveshja gjithashtu vendos rregullat dhe parimet prej të cilave do të drejtohet ky bashkëpunim dhe siguron një zhvillim progresiv të transportit ndërmjet dy vendeve, të mbështetur në nevojat reciproke komerciale dhe kushtet e hyrjes në tregun e transportit ajror.

Marrëveshja përbëhet nga 37 nene dhe nga shtojca A, në të cilën parashikohen linjat e specifikuar në të dyja shtetet palë, ku përcaktohen linjat ajrore që kanë të drejtë të kryejnë shërbime ajrore ndërkombëtare të planifikuara në të dyja drejtimet.

III. ÇËSHTJE TË DISKUTUARA NË KOMISION

Gjatë shqyrtimit të projektligjit në Komision nga relatori u vlerësua ndërmarrja e kësaj nisme ligjore, e cila synon synon për të krijuar hapësira dhe mundësi më të mira për shtetasit e të dyja palëve për transport udhëtarësh, mallrash dhe dërgesash postare. .

Pas paraqitjes së relatimit nga deputetja Mara, mbledhja e Komisionit vijoi me diskutimin e përmbajtjes së projektligjit, ku deputetët drejtuan pyetje për të cilat morën përgjigjet dhe sqarimet përkatëse nga përfaqësuesit e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

IV. PËRFUNDIM

Në përfundim të shqyrtimit të këtij projektligji, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, pasi vlerësoi se:

- a) **Në aspektin ligjor**, projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;
- b) **Në aspektin procedural**, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit;

dhe pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, me votat e të gjithë anëtarëve të pranishëm e miratoi atë, dhe u shpreh dakord për kalimin për votim në seancë plenare.

RELATORI

KRYETARI

AURORA MARA

ULSI MANJA